

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6207  
E enjte, 7 janar 2021  
çmimi 0.40 €

## Nisin hetimet për shpërthimin e bombolës në Ferizaj



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS KA PUBLIKUAR AKTGJYKIMIN E PLOTË LIDHUR ME VOTIMIN E QEVERISË HOTI

## HAPET RRUGA PËR ZGJEDHJET E REJA



Gjykata Kushtetuese i ka hapur rrugë shpalljes së datës së zgjedhjeve të reja parlamentare, duke publikuar aktgjykimin e plotë lidhur me votimin e qeverisë Hoti. Tani ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, mund ta shpallë datën

e mbajtjes së zgjedhjeve. Në aktgjykimin prej 65-faqesh, Kushtetuesja ka konstatuar se vota e deputetit Etem Arifi, që ishte i dënuar me vendim të prerë gjyqësor, ishte e pavlefshme. Aktgjykimi konstaton se një person i dënuar për

vepër penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tre vjetët e fundit, nuk mund të jetë pjesë e listës për deputet. Sipas paragrafit 260 të aktgjykimin, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, nuk mund të kandidojë në garën për deputet

## KUVAJTI DHE IRAKU, VENDET E MUNDSHME KU DO TË DËRGOHET FSK-JA



Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka deklaruar se vendimi i Kuvendit të Kosovës për të votuar për dërgimin e kontingjentit të FSK-së jashtë vendit

është ndër hapat më të rëndësishëm që ka bërë Kosova si shtet. Para pjesëtarëve të kësaj force, ai ka thënë se ky veprim FSK-në e dërgon drejt inte-

grimit të plotë në strukturat euroatlantike. Hoti ka bërë me dije se Kuvajti dhe Iraku janë vendet e mundshme ku do të dërgohet FSK-ja

## NGA SHKURTI, 20 MIJË QYTETARË DO TË VAKSINOHEN KUNDËR COVIDIT BRENDË DITËS

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



**LLADROVCI SHPALL KANDIDATURËN PËR MANDATIN E DYTË PËR KRYETAR TË DRENASIT** F. 10

**META: KOSOVA E MERITON TË JETË SA MË PARË ANËTARE E NATO-s** F. 3

**KRYETARJA E KQZ-SË NJOFTON KOMANDANTIN E KFOR-IT PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE TË REJA** F. 5

**ARDIAN KASTRATI I BASHKOHET PDK-së** F. 7

### EKONOMI

**MINISTRI KUÇI TAKON AKTORËT E SEKTORIT PAS PAVARËSIMIT ENERGETIK** F. 8

**BQK-ja: HOTELERIA, TREGTIA DHE NDËRTIMTARIA, SEKTORËT QË SHËNUAN RËNIE GJATË PANDEMISË** F. 8

### KULTURË

**RINOVHET OBORRI I "NAMAZXHAHUT" QË ËSHTË PJESË E TRASHËGIMISË KULTURORE** F. 12

### SPORT

**YLLI TRIUMFON KUNDËR PEJËS, PRISHTINA SHIJON FITOREN NË GJAKOVË** F. 12

## Ekipit të OBSH-së i ndalohet hyrja në Kinë

GJENEVE, 6 JANAR - Anëtarëve të një ekipi të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) u është ndaluar hyrja në Kinë. Ekipi duhej ta hetonte origjinën e Covidit në Vuhan. Pekini kishte rënë dakord për këtë vizitë në dhjetor, pas shumë muajsh negociatash me OBSH-në. Dy zyrtarë ishin nisur në

udhëtimin e tyre por, njëri tani është kthyer dhe tjetri është në transit në një vend të tretë.

Shefi i OBSH-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka thënë se ndalesa ndodhi për shkak të mungesës së vizave dhe ai ishte shumë i zhgënjyer që Kina nuk kishte siguruar ende lejet për ekipin

“duke pasur parasysh se dy anëtarë kishin filluar udhëtimet e tyre dhe të tjerët nuk ishin në gjendje të udhëtojnë në minutën e fundit”. Ai shtoi se kishte qenë në kontakt me zyrtarë të lartë kinezë për të theksuar “se misioni është një përparësi për OBSH-në dhe ekipin ndërkombëtar”.



## ShBA-ja shënjestron me sanksione sektorin e metaleve të Iranit



NJU JORK, 6 JANAR - Shtetet e Bashkuara kanë vendosur në listë të zezë 16 kompani dhe një individ të lidhur me industrinë e metaleve të Iranit si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme nga administrata në largim e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, për t'i penguar përfitimet e këtij vendi.

Departamenti i Thesarit në ShBA ka njoftuar se më 5 janar ka shënjestruar sektorin e

metaleve iraniane sepse është një “burim i rëndësishëm i të ardhurave” për udhëheqjen iraniane, “duke gjeneruar pasuri për udhëheqësit e saj të korruptuar dhe duke financuar një sërë aktivitete të këqija, duke përfshirë përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, mbështetjes për grupet e huaja terroriste dhe një shumëllojshmëri të shkeljeve të të drejtave të njeriut, brenda dhe jashtë vendit”.

Sipas sanksioneve, pasuritë e subjekteve dhe individëve në shënjestër që bien nën juridiksionin e ShBA-së janë të ngrira dhe qytetarëve amerikanë u ndalohet të bashkëpunojnë me këto subjekte.

Në maj 2019, Shtetet e Bashkuara njoftuan se pari sanksionet që synojnë sektorët e çelikut, aluminit, bakrit dhe hekurit të Iranit, të gjitha burimet kryesore të të ardhurave për vendin.

## Rregullatori evropian miraton përdorimin e vaksinës “Moderna”

BRUKSEL, 6 JANAR - Rregullatori i barnave i Bashkimit Evropian miratoi të mërkurën përdorimin e vaksinës “Moderna” kundër sëmundjes Covid-19.

Vaksina është krijuar nga kompania amerikane me po të njëjtin emër. Ajo është e dyta që autorizohet nga Agjencia Evropiane e Barnave, pasi vaksina “Pfizer/BioNTech” e

ka marrë dritën jeshile në fund të dhjetorit.

Miratimi i “Modernës” vjen në kohën kur BE-ja po përballë me kritika për fushatën e ngadalshme të imunizimit, e cila mbetet prapa Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar apo Izraelit.

“Kjo vaksinë na ofron një mjet



tjetër për ta kapërcyer emergjencën aktuale”, ka

thënë drejtoresha ekzekutive e Agjencisë Evropiane të Barnave, Emer Cooke.

Shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka theksuar se ky është “një lajm i mirë për përpjekjet tona, për të sjellë sa më shumë vaksina Covid-19 tek evropianët”. Bashkimi

Evropian ka nisur vaksinimin më 27 dhjetor, por ritmi ka qenë i ngadaltë. Vaksina “Moderna” është thënë se është 94.1 për qind efektive.

Agjencia Evropiane e Barnave ka thënë javën e kaluar se vaksina e zhvilluar nga kompania “AstraZeneca” dhe Universiteti i Oksfordit nuk ka gjasa ta marrë dritën jeshile në BE në muajin e ardhshëm.

## Spanjë, papunësia u rrit 23 për qind në vitin 2020

MADRID, 6 JANAR - Dëmi ekonomik i shkaktuar nga pandemia e Covid-19 i dha fund pesë vjetëve radhazi të rimëkëmbjes së punësimit në Spanjë, që regjistroi një rritje të papunësisë të barabartë me 23 për qind në vitin 2020, sipas të dhënave të lëshuara nga Ministria e Punës. “Në

fund të dhjetorit numri i të papunëve u rrit me + 724 532, në 3 888 137, në krahasim me vitin e kaluar”, raportoi në faqen e tij në internet “The Guardian”. Vetëm muajin e kaluar u regjistruan si të papunë 36 825 persona. “Një total prej 360 000 vendesh pune morën fund në vitin

2020, duke marrë parasysh numrin e personave që paguajnë kontribute të sigurimeve shoqërore”, ka raportuar “The Guardian”. Shifrat negative i dhanë fund rimëkëmbjes së punësimit, që filloi më 2014, pas një rritjeje të papunësisë pas krizës financiare të vitit 2008.



## Daçiçi dhe Vulini imunizohen me vaksinën ruse

Beograd, 6 janar - Kryetari i Kuvendit të Serbisë, Ivica Daçiçi dhe ministri i Brendshëm i Serbisë, Aleksandar Vulin, kanë marrë

vaksinën ruse kundër Covid-19 ‘Sputnik V’ në Institutin e Virologjisë Torlak në Beograd. Siç theksohet në njoftimin e Qeverisë së Serbisë, vaksinën

ruse e kanë marrë edhe një sërë zyrtarësh të tjerë serbë, përfshirë Marija Gnjatoviç, nga Instituti për Energjinë Bërthamore, Dragana Despot,

drejtoreshë e Institutit për Biocide dhe Ekologji Mjekësore dhe Mirsad Gjerlek, sekretar i Shtetit në ministrinë e Shëndetësisë së Serbisë.



Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka vizituar Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK)

## Kuvajti dhe Iraku, vendet e mundshme ku do të dërgohet FSK-ja

Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka deklaruar se vendimi i Kuvendit të Kosovës për të votuar për dërgimin e kontingjentit të FSK-së jashtë vendit është ndër hapat më të rëndësishëm që ka bërë Kosova si shtet. Para pjesëtarëve të kësaj force, ai ka thënë se ky veprim FSK-në e dërgon drejt integritit të plotë në strukturat euroatlantike. Hoti ka bërë me dije se Kuvajti e Iraku janë vendet e mundshme ku do të dërgohet FSK-ja



**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 6 JANAR** - Një ditë pasi Kuvendi i Kosovës ka votuar për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) jashtë vendit, kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka vizituar të mërkurën FSK-në, duke e cilësuar shumë të rëndësishëm këtë veprim të Kuvendit. Para ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së në kazermën "Adem Jashari", Hoti ka thënë se vendimi i së martës mundëson integrimin e plotë të FSK-së në strukturat euroatlantike. "Nganjëherë për vendime të tilla duhet ndoshta një distancë e caktuar kohore për të kuptuar plotësisht sa të rëndësishme janë. Vendimi që ka marrë dje Kuvendi i Kosovës është ndër hapat më të mëdhenj historikisht që kemi bërë si shtet dhe se FSK-ja drejt integritit të plotë të FSK-së në strukturat euroatlantike, është ëndërr e jona. Besoj se vetëm njerëzit, qytetarët dhe liderët tepër vizionarë kanë pasur mundësi për ta parashikuar atëherë kur është themeluar ushtria e Republikës së Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, në rrethanat e asaj kohe kur është dizajnuar është parashikuar që

shteti i Kosovës të jetë pjesë dhe të integrohet plotësisht në strukturat euroatlantike", ka thënë Hoti.

Kryeministri Hoti ka theksuar se qytetarët e Kosovës e dinë se sa e rëndësishme është për një popull që ka nevojë për paqe dhe stabilitet, ta ketë mbështetjen e miqve dhe partnerëve ndërkombëtarë. Ai nënvizoi se ndihet vërtet i privilegjuar që në mandatin e kësaj qeverie u miratua vendimi për bashkëdërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në misionet jashtë vendit me Gardën Kombëtare të Ajovës. "Besoj se qytetarët dhe liderët tepër vizionarë kanë pasur mundësi ta parashikojnë në fillim të viteve '90, atëherë kur është themeluar Ushtria e Republikës së Kosovës, Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës, që shteti i Kosovës të jetë pjesë dhe të integrohet plotësisht në strukturat euroatlantike", ka deklaruar Hoti.

Hoti ka thënë se Kuvajti dhe Iraku janë vendet ku Forca e Sigurisë së Kosovës do të mund të marrë pjesë në misionet paqeruajtëse, në kuadër të misionit të Gardës Kombëtare të Ajovës, të Ushtrisë Amerikane. Hoti ka pohuar se

këto vende kanë qenë si opsione që janë shqyrtuar dhe se tani pritet konfirmimi zyrtar. Sipas tij, FSK-ja mund të dërgohet në këto misionet në muajin mars.

Me këtë rast ka folur edhe ministri në detyrë i Mbrojtjes, Anton Quni. Ai ka thënë se rruga për të arritur deri këtu nuk ka qenë e lehtë. "Është dashur angazhim dhe përkushtim i jashtëzakonshëm politik dhe diplomatik, por rolin kryesor për këtë të arritur e kemi ju me performancën tuaj në secilin veprim, sjellje e aktivitet tuajin. Ju, me performancën tuaj në kurse trajnuese, individuale e grupore, stërvitje në njësitë tuaja dhe ato të përbashkëta ndërkombëtare me partnerët tanë, keni bindur dhe fituar besimin e plotë të aleatëve tanë

se jeni të denjë për t'i realizuar detyrat tuaja taktike e operative në operacione të përbashkëta. Ju, me rezultatet e jashtëzakonshme të arritura në qendrat dhe institutet profesionale, akademitë ushtarake e kolegjet e luftës, keni dëshmuar nivel të lartë të kulturës e dijes akademike ushtarake para aleatëve tanë si garanci e fuqishme se dini dhe mund të realizoni detyra planifikuese shtabore, si dhe ato të komandimit e drejtimit strategjik të forcave e njëjve operacionale", ka thënë Quni. Ai ka vlerësuar se besimi i ShBA-së natyrshëm e shton edhe më shumë vlerën e kësaj të arriture historike. "Ne me forcat amerikane jemi ndier gjithmonë një. Tani me forcat amerikane, përveç zemrave e mendjeve, do t'i kemi një edhe

trupat e armët tona në misionet e shenjta në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit për mbarë njerëzimin. Ky është misioni ynë drejt përmbushjes së vizionit tonë për integrimin në NATO, respektivisht familjen euroatlantike, aty ku kemi qenë historikisht me qenien e identitetin tonë mijëvjeçar", është shprehur Quni.

Pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës në mars të këtij viti do ta nisnin misionin e parë paqeruajtës në botë. Ata do të jenë përkrah Gardës Kombëtare të Ajovës. Me 92 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët kanë dhënë miratimin për dërgimin e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në misionet paqeruajtëse në kuadër të Forcës Kombëtare të shtetit amerikan të Ajovës.

## Meta: Kosova e meriton të jetë sa më parë anëtare e NATO-s

**Prishtinë, 6 janar (ER)** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka përshëndetur vendimin e Kuvendit të Kosovës për ta autorizuar Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) të marrë pjesë në misionet paqeruajtëse në botë, në bashkëpunim me ushtrinë amerikane. Ai ka thënë se Kosova e meriton plotësisht të jetë sa më parë anëtare e NATO-s. "Përshëndes vendimin historik të Kuvendit të Kosovës për ta autorizuar Forcën e

Sigurisë së Kosovës të marrë pjesë në misionet paqeruajtëse në botë, në bashkëpunim me ushtrinë amerikane. Kosova dëshmon qartë çdo ditë se është jo vetëm një faktor i rëndësishëm për paqen, stabilitetin e sigurinë në rajon, por edhe promovuese e këtyre vlerave në botë. Kosova e meriton plotësisht të jetë sa më parë anëtare e NATO-s dhe do ta ketë mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë në këtë drejtim", ka thënë Meta.





GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS KA PUBLIKUAR AKTGJYKIMIN E PLOTË LIDHUR ME VOTIMIN E QEVERISË HOTI

# HAPET RRUGA PËR ZGJEDHJET E REJA

Gjykata Kushtetuese i ka hapur rrugën shpalljes së datës së zgjedhjeve të reja parlamentare, duke publikuar aktgjykimin e plotë lidhur me votimin e qeverisë Hoti. Tani ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, mund ta shpallë datën e mbajtjes së zgjedhjeve. Në aktgjykimin prej 65-faqesh, Kushtetuesja ka konstatuar se vota e deputetit Etem Arifi, që ishte i dënuar me vendim të prerë gjyqësor, ishte e pavlefshme. Aktgjykimi konstaton se një person i dënuar për vepër penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tre vjetët e fundit, nuk mund të jetë pjesë e listës për deputet. Sipas paragrafit 260 të aktgjykimit, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, nuk mund të kandidojë në garën për deputet

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 JANAR - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka publikuar të mërkurën aktgjykimin e plotë lidhur me votimin e Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Avdullah Hoti. Në këtë mënyrë është hapur rruga për caktimin e datës për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 40 ditë nga dita e shpalljes së tyre nga presidenti.

Në aktgjykimin prej 65-faqesh, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar rrëzimin e qeverisë Hoti, duke vlerësuar se vota e deputetit Etem Arifi, që ishte i

dënuar me vendim të prerë gjyqësor, ishte e pavlefshme. "Gjykata konsideron të rëndësishme të vë në dukje se kandidimi në zgjedhje parlamentare i Etem Arifit, zgjedhja e tij deputet dhe ushtrimi i mandatit të deputetit, të gjitha këto pasi që ai ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë shpërfaqin ekzistimin e paqartësisë normative dhe të metave serioze në mekanizmat institucionale të Republikës së Kosovës, që janë kompetente për ta garantuar ligshmërinë dhe integritetin kushtetues të proceseve zgjedhore dhe veprimtarisë parlamentare. Kjo

paqartësi është e dukshme edhe në përgjigjet që janë dhënë nga trupat përkatëse të Kuvendit dhe nga KQZ-ja", është thënë në aktgjykimin e gjykatës.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se për të shmangur në të ardhmen situata të tilla, duhet koordinim institucional kur bëhet fjalë për kandidimin në zgjedhje parlamentare dhe ushtrimin e mandatit të deputetit, nga ana e personave të dënuar për vepra penale. "Kjo është e domosdoshme për t'i shmangur situatat paradoksale, nga këndvështrimi kushtetues, ku një person, pasi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë sikurse parashihet me nenet përkatëse të Kushtetutës

## Specialja ua vazhdon paraburgimin Hysni Gucatit e Nasim Haradinajt

PRISHTINË, 6 JANAR - Gjyqtari i procedurës paraprake, Nicollas Guillo, ua ka vazhduar paraburgimin dy krerëve të OVL-së së UÇK-së, Hysni Gucati e Nasim

Haradinaj. Me këtë rast, Guillo ka kërkuar nga palët që deri më 1 shkurt t'i dërgojnë parashtruesat e tyre për lirim me kusht, pra deri në rishikimin tjetër të

paraburgimit. Vendimi për zgjatjen e paraburgimit është marrë, më 24 dhjetor, mirëpo që është bërë publik tashti së fundmi. Gjykata ka konsideruar në

vendimin e saj se me gjithë kushtet e propozuara nga avokatët mbrojtës, ekziston sërish rreziku që të akuzuarit të ndërhyjnë në proces.



dhe ligjeve, i lejohet të kandidojë në zgjedhje parlamentare, të zgjidhet deputet, t'i verifikohet mandati, si dhe të vazhdojë ta ushtrojë funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, madje edhe gjatë vuajtjes së dënimit me burgim. Ndërkohë që Kushtetuta dhe ligjet përkatëse vënë barriera të qarta normative për të mos lejuar personat e dënuar me burgim për kryerjen e veprave penale, që të zgjedhën deputetë dhe ta ushtrojnë mandatin e deputetit", është thënë në aktgjykimin e Kushtetueses.

Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se për shkak që vota e Arifit ishte e pavlefshme, qeveria Hoti nuk kishte marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve, përkatësisht 61 vota. Andaj, Kushtetuesja thotë se presidenti i Republikës duhet t'i shpallë zgjedhjet e reja.

Gjithashtu, në paragrafin 260 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese thuhet se një person i dënuar për veprë penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tre vjetët e fundit, nuk mund të jetë kandidat për deputet e as të ketë mandat të vlefshëm në Kuvendin e Kosovës.

Në këtë mënyrë, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, nuk mund t'i hyjë garës në zgjedhje në listën e deputetëve. "Në vlerësimin e Gjykatës, neni 70.3.6 i Kushtetutës, neni 8.1.6 i Ligjit për të Drejtat dhe

Përgjegjësitë e Deputetit dhe nenin 112.1 (a) dhe (c) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duhet të lexohen në mënyrë të ndërthurur me nenin 71.1 të Kushtetutës dhe nenin 29.1.q të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Qëllimi i përbashkët i këtyre neneve kushtetuese dhe ligjore është që:

a) personat e dënuar për vepra penale me vendime gjyqësore të formës së prerë, të vlefshme në Republikën e Kosovës, të mos mund të kandidohen e as të zgjidhen si deputet, nëse janë dënuar gjatë tri vjetëve të fundit para zgjedhjeve; dhe b) të mos mund ta ushtrojnë mandatin e deputetit nëse janë të dënuar me një apo më tepër vite burgim, me një vendim gjyqësor të formës së prerë, të vlefshëm në Republikën e Kosovës" është thënë në këtë paragraf.

Gjykata Themelore në Prishtinë në janar të vitit 2018 kishte shpallur fajtorë katër deputetët e Kuvendit të Kosovës, Albin Kurti, Donika Kadaj-Bujupi, Albulena Haxhiu dhe Faton Topalli, për dy veprat penale, atë të përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm dhe për pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, veprime këto që lidhen me hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës në vitin 2015.

Albin Kurti ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm, kurse për veprën penale të pengimit të personit

## Tomë Gashi: Albin Kurti ka të drejtë të kandidojë për deputet

Avokati Tomë Gashi ka thënë se lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, në bazë të pikës 297 të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për çështjen e qeverisë Hoti, ka të drejtë kandidimi për deputet në zgjedhjet e ardhshme të parakohshme. Në profilin e tij në "Facebook", ai ka shkruar se Kurti i është shqiptuar dënim alternativ. "Albin Kurti ka të drejtë të kandidojë për deputet të Kuvendit të Kosovës. Kushdo që ka pasur paqartësi lidhur me të drejtën për të qenë kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pika 297 e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, datë 6 janar 2021, e sqaron në tërësi këtë situatë duke konstatuar se: 'Nuk lejohet që një person i dënuar me burgim gjatë tri



vjetëve të fundit para zgjedhjeve të kandidoj për deputet dhe ta fitoj mandatin e deputetit'. Albin Kurti në 2018 iu shqiptua masa e dënimit me kusht i cili është

dënim alternativ dhe nuk prodhon pasoja juridike (Neni 46 i Kodit Penal të Kosovës)", ka shkruar Gashi, duke shtuar se shumë shpejt Albin Kurti do të jetë kryeministër i Kosovës.

zyrtar është dënuar me gjashtë muaj burgim. Ndaj tij është shqiptuar dënim unik prej një vit e gjashtë muaj burgim me kusht.

Më 21 dhjetor 2020 Kushtetuesja kishte konstatuar se qeveria e zgjedhur më 3 qershor 2020 nuk ishte në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 [zgjedhja e qeverisë] të Kushtetutës sepse qeveria nuk

kishte marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve.

Palët në këtë rast ishin qeveria tashmë në detyrë e Kosovës dhe partia opozitare, Lëvizja Vetëvendosje.

Ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, tashmë ka mbajtur takimet e para me përfaqësuesit e partive politike për konsultime rreth datës për zgjedhjet e reja por,

sipas saj, vendimi do të merret pasi palët ta marrin aktgjykimin e plotë të Gjykatës Kushtetuese për Qeverinë e Kosovës. Përfaqësuesit e partive politike, pas takimit me ushtruesen e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, kanë përmendur fundin e muajit janar dhe fillimin e shkurtit të vitit 2021, si periudha të mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve.

## Hasani: Kurti mund të jetë kryeministër, por jo deputet

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të publikuar të mërkurën, nuk do të ketë të drejtë të garojë për deputet në zgjedhjet e reja, ka thënë ish-kryetari i Kushtetueses, Enver Hasani. Duke folur për "Radion Evropa e lirë", Hasani ka thënë se aktgjykimi e ka qartësuar se të gjithë personat e dënuar me gjykim të formës së prerë në tre vjetët e fundit, nuk kanë të drejtë të kandidojnë për deputetë dhe të marrin mandat nga Kuvendi i Kosovës. "Nuk ka të drejtë, është e qartë ajo që e ka thënë Gjykata Kushtetuese", ka thënë Hasani. Ai ka bërë me dije se Kurti mund të



nominohet për postin e kryeministrit, nëse partia e tij, Lëvizja Vetëvendosje, i fiton zgjedhjet.



## Kryetarja e KQZ-së njofton komandantin e KFOR-it për organizimin e zgjedhjeve të reja

PRISHTINË, 6 JANAR - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka pritur në takim njoftues komandantin e KFOR-it,

gjeneralmajor Franco Federici. Fillimisht Daka ka uruar Federicin për angazhimin e tij në Kosovë dhe e ka informuar për punën e Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për organizimin e proceseve zgjedhore në Republikën e Kosovës. Ndërsa komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor

Franco Federici, ka shprehur mbështetje për punën e KQZ-së, derisa i ka dhuruar kryetares së KQZ-së një dhuratë simbolike.



# Nga shkurti, 20 mijë qytetarë do të vaksinohen kundër Covidit brenda ditës

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 6 JANAR** - Kosova planifikon t'i vaksinonjë 20 mijë qytetarë kundër Covid-19 brenda ditës pasi të arrijnë vaksinat e para në muajin shkurt ka thënë kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, i cili, në një konferencë për media, ka prezantuar strategjinë për vaksinimin e popullatës kundër sëmundjes Covid-19 dhe tha se janë tri grupe që do të kenë prioritet për vaksinim: punonjësit dhe stafi shëndetësor, personat mbi 65 vjeç dhe personat me rrezikshmëri të lartë, pra ata me sëmundje kronike. "Ne presim sikurse në vendet e rajonit, vaksinat e para të vijnë në muajin shkurt. Kemi siguruar buxhetin. Siç e dini, është miratuar buxheti për vitin 2021 dhe janë ndarë 40 milionë euro vetëm për vaksinën anti-Covid kështu që ne jemi të përgatitur për këtë proces të rëndësishme", ka thënë Hoti.

Ai ka treguar se të martën u konkretizuan negociatat me kompaninë amerikane "Pfizer" për sigurimin e 535 mijë dozave të vaksinës. Po ashtu, Hoti ka thënë se kanë negociuar për marrjen e 600 mijë dozave të vaksinave nga Austria si dhe nga programi COVAX i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Kosova pritet të marrë 720 mijë doza, apo vakcina të mjaftueshme për 20

për qind të popullatës. Hoti, megjithatë, nuk specifikoi se të cilës kompani janë vaksinat që Kosova pritet t'i marrë nga Austria. Hoti ka njoftuar se të gjithë qytetarët që do të vaksinohen do të futen në një databazë dhe ata do të pajisen me një kartelë të imunizimit. Ai ka thënë se pret që strategjia e hartuar nga komiteti për imunizim, të vijë në Qeveri të Kosovës për miratim.

Ndërkaq ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë që kësaj jave do të finalizohen të gjitha aspektet teknike të negociatave me kompaninë "Pfizer", vaksinat e së cilës do të arrijnë në Kosovë në shkurt.

Ministri në detyrë, Zemaj, ka thënë se kanë aplikuar edhe për asistencë teknike, që nënkupton asistencë për ruajtjen, shpërndarjen dhe dhënie e vaksinës në popullatën e targetuar, duke shtuar se fushatës së vaksinimit do t'i paraprijë një fushatë informuese. "Të gjithë qytetarët që duhet vaksinuar, do të vaksinohen dhe tanimë kjo është e siguruar", ka pohuar Zemaj, duke shtuar se të gjitha vaksinat do të jenë falas. "COVAX dhe 'Pfizer' nuk janë të vetmet mundësi që ne kemi shqyrtuar për sigurimin e vaksinave. Kemi kontaktuar, identifikuar dhe negociuar edhe me shtete veç e veç nga Bashkimi Evropian, duke filluar nga ajo që ka bërë



kryeministri (në detyrë) Hoti me Komisionin Evropian dhe me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor", ka deklaruar Zemaj.

Drejtori i Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike, Naser Ramadani, ka thënë se ky institucion është i gatshëm që ta mbikëqyrë fushatën e vaksinimit, e cila do të kryhet në Qendrat e Mjekësisë Familjare në Kosovë. "Vaksinat nuk janë të detyruara, nuk janë të obliguara, por janë të rekomanduara", është shprehur Ramadani. Ai ka theksuar se në

Ministrinë e Shëndetësisë është duke u finalizuar projekti i zinxhirit të ftohtë që, sipas tij, ka për qëllim që të ketë "kapacitete maksimale të ruajtjes dhe shpërndarjes së vaksinës". "Ne tashmë në dispozicion kemi mundësi t'i kemi, pos 'Pfizer', edhe 'Moderna', 'AstraZeneca', pra cilado vaksinë që ne tashmë jemi në rrugë e sipër që ta sigurojmë, ne jemi të gatshëm që ta zbatojmë në terren", ka deklaruar Ramadani.

Vaksina e "Pfizerit", që e ka prodhuar në bashkëpunim me

kompaninë gjermane "BioNTech", kërkon që të ruhet në temperaturë -70 gradë celsius.

Ramadani ka pohuar se IKShPK-ja shpreson që me fushatën e vaksinimit të mbulohet e gjithë ajo pjesë e shoqërisë që është e targetuar si prioritet, në mënyrë që të krijohet imunitet ndaj sëmundjes Covid-19. Edhe Zemaj ka theksuar se masat kundër Covid-19 do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i respektojnë ato.

## Edhe dy të vdekur dhe 301 raste të reja me Covid në Kosovë

**PRISHTINË, 6 JANAR (ER)** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 459 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 301 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Fushë-Kosovë një rast (80 vjeç), Prishtinë një rast (58 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 52 634 raste nga 190 879 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 357 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë

shëruar 457 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 43 835 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7 442. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 103 raste, Podujevë 32 raste, Fushë-Kosovë 20 raste, Pejë 17 raste, Lipjan 16 raste, Vushtrri 15 raste, Mitrovicë 14 raste, Drenas 13 raste, Ferizaj 12 raste, Gjakovë 10 raste, Obiliq 10 raste, Gjilan 6 raste, Shtime 6 raste, Prizren 5 raste, Rahovec 5 raste, Malishevë 4 raste, Viti 4 raste, Kamenicë 2 raste, Klinë 2 raste, Skenderaj 2 raste, Suharekë 2 raste dhe Dragash 1 rast.

IKShPK-ja u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të vijnë të testohen për Covid-19 sipas indikacioneve epidemiologjike, në të gjitha qendrat rajonale të shëndetësisë publike në Kosovë.



# Nisin hetimet për shpërthimin e bombolës në Ferizaj

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, ka njoftuar se ka filluar hetimet me rastin e shpërthimit të bombolës së gazit që ka ndodhur në restorantin "Steak House" në Ferizaj. Si pasojë e shpërthimit të saj kanë mbetur të lënduar 44 persona. Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka treguar se po bëhen të gjitha përpjekjet nga stafi shëndetësor, por edhe drejtuesit e institucioneve shëndetësore që të lënduarve t'u mundësohet trajtimi i specializuar shëndetësor jashtë vendit



nevojshme me qëllim të zbardhjes së këtij rasti dhe rrethanave që kanë çuar deri në ngjarjen tragjike.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se janë duke bërë përpjekje maksimale që të lënduarit me gjendje më të rëndë t'i dërgojnë për në Turqi. Ai ka thënë se Ferizaj do ta kapërcejë edhe këtë plagë. "Të gjithë jemi me lutjet tona për shërimin e të lënduarve dhe pranë familjeve të tyre. I jashtëzakonshëm ishte edhe reagimi i mjekëve dhe infermierëve ferizajas dhe stafit teknik nga komunat fqinje, Policisë së Kosovës, zjarrfikësve, solidarizimi i bizneseve me këtë fatkeqësi të qytetarëve të rastit që me reagimin e shpejtë, parandaluan zgjerimin e tragjedisë", ka thënë Aliu. Ndërkaq ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, pasi ka vizituar të lënduarit, ka thënë se spitali i Ferizajt,

emergjenca e qytetit, policia, zjarrfikësit dhe qytetarët, kanë dëshmuar nivel të lartë të përkujdesjes ndaj dhjetëra të plagosurve pas eksplozimit të gazit në Ferizaj. "Ky trajtim në Spitalin e Ferizajt dhe në Qendrën Emergjente në QKUK ndaj qytetarëve të lënduar deri më tani është në nivelin maksimal. Së bashku me kryetarin Agim Aliu, zëvendësministrin Muharrem Sfarqa dhe deputeten Saranda Musliu kemi diskutuar për të gjitha mundësitë e përkujdesjes shëndetësore që gjendja e secilit qytetar të jetë në nivelin e duhur dhe të bëjmë çmos që të mos rrezikohet jeta e asnjë qytetari të lënduar. Do të jemi pranë të gjithë pacientëve të lënduar dhe ju urojmë shërim të shpejtë", ka thënë Zemaj.

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

FERIZAJ, 6 JANAR - Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, ka njoftuar opinionin publik se ka filluar hetimet në lidhje me rastin e shpërthimit që ka ndodhur në restorantin

"Steak House" në Ferizaj, ku si pasojë e tij mbetën të lënduar dyzet e katër (44) persona.

Dyshimet e para lidhur me këtë rast janë që ka shpërthyer një bombolë gazi dhe ky rast është cilësuar si "shkaktim i rrezikut të përgjithshëm". Prokuroria, në bashkëpunim me policinë, janë duke mbledhur informatat e



## Ardian Kastrati i bashkohet PDK-së

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Kandidati për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka prezantuar ardhjen e profesorit të Shkencave Politike, Ardian Kastrati, i cili të mërkurën i është bashkuar PDK-së. Hoxhaj, duke i uruar mirëseardhje Kastratit, ka theksuar se PDK-ja është parti e vlerave që gjithmonë i ka hapur dyert për intelektualët e vendit, që ka hapur universitete të reja, që ka ulur shpenzimet e studentëve në universitete publike dhe parti që ka promovuar zhvillimin akademik të profesorëve. Hoxhaj ka thënë se Kastrati vjen si një vlerë e shtuar për PDK-në për shkak të pasionit të tij për politikën dhe sferën publike, të cilën e ka dëshmuar jo vetëm së voni përmes komenteve dhe analizave të tij politike, por edhe më parë përmes angazhimit dhe aktivizmit të drejtpërdrejtë për të mirën e përgjithshme. "Ardian Kastrati ka qenë anëtar

i Kryesisë së Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, në kohën kur ky union organizoi demonstratat studentore të viteve 1997 dhe 1998. Partia Demokratike e Kosovës është një parti e ushtarëve të UÇK-së dhe e të burgosurve politikë. PDK-ja është parti e frymës së rezistencës dhe mosbindjes ndaj Jugosllavisë në të gjitha etapat e okupimit. Prandaj, një profil i aktivistit të rezistencës studentore si Ardian Kastrati, pa dyshim që natyrshëm i ka dyert e hapura në PDK dhe natyrshëm e gjen veten në vijën politike që përfaqëson PDK-ja", ka thënë Hoxhaj.

Sipas Hoxhajt, përmes këtij aderimi PDK-ja si shtëpi e madhe që është në proces reformimi ka hapur dyert për intelektualët dhe ekspertët të cilët janë vlerë e shtuar për partinë dhe garanci e fitores së përbashkët. "Ky dhe aderimet e tjera nuk janë thjesht emra konkretë. Këta janë një frymë që po ekziston brenda dhe



jashtë partisë. Brenda partisë ekziston fryma e hapjes, reformimit dhe mirëseardhjes për kuadrot e reja, ndërsa jashtë partisë është fryma e besimit të PDK-ja për të punuar në PDK dhe me PDK-në për të sjellë ndryshime pozitive në

qeverisjen e re të udhëhequr nga PDK-ja", ka përfunduar Hoxhaj.

Ndërsa Ardian Kastrati, duke e falënderuar Hoxhajn për pritjen, ka thënë se roli i tij si intelektual ka bërë që të mos qëndrojë indiferent përballë

proceseve të komplikuar politike që po kalon Kosova dhe ndërgjegjja e shtyrë që t'i bashkohet PDK-së për të ofruar një Kosovë më të sigurt për pasardhësit sepse, sipas tij, kur PDK-ja nuk qeveris, në Kosovë ka stagnim.

# Ministria e Infrastrukturës: Rrugët janë të kalueshme, në disa prej tyre ka pasur intervenime

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se të gjitha rrugët janë të kalueshme dhe po mirëmbahen nga operatorët ekonomikë të kontraktuar. Intervenime ka pasur në largimin e erodimeve sidomos në viset malore, kompanitë kanë intervenuar me pastrim dhe hedhje të kripës. Në rajonin e Gjakovës gjendja e rrugëve është e mirë. Gjatë ditës dhe natës së kaluar ka pasur reshje të shiut dhe është intervenuar me kripë ku ka pasur nevojë.

Autoudha R6, Doganaj - Hani i Elezit, si dhe regjioni i Ferizajt janë krejtësisht të lira për qarkullim.

Në rajonin e Gjilanit 1 gjendja e rrugëve është e mirë, ka pasur lagështirë në rrugë dhe është hedhur kripë sipas nevojës. Ndërsa në Gjilani 2 të gjitha rrugët janë në gjendje të mirë, në disa pjesë, për shkak të reshjeve të shiut, ka erodime dhe rrëshqitje të dheut. Ndërsa në regjionin e

Prizrenit, intervenime me kripë kishte në drejtimin Prizren - Carralevë.

Në autoudhën A7, drejtimi Suharekë - Morinë dhe në drejtimin Suharekë - Gjurgjicë kishte intervenime me kripë.

Në rrugën Pejë - Bogë dhe Deçan - Kozhnjer ka reshje të lehta të borës. "Në orët e hershme të mëngjesit dhe në mbrëmje kanë qenë temperatura mjaft të ulëta dhe si rrjedhojë bëhet shpërndarja e kripës në të gjitha rrugët e regjionit Peja 1. Ndërsa në Peja 2 nuk kishte intervenime dhe rrugët janë krejtësisht të lira për qarkullim. Për shkak të temperaturave nën zero është intervenuar me kripë e rërë në të gjitha rrugët e regjionit Prishtina 1, si preventivë për parandalim të krijimit të ngricave në shtresat qarkulluese", ka njoftuar kjo ministri.

Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se pas paraqitjes së plasaritjeve, gjegjësisht deformimeve në rrugën



nacionale N2, segmenti rrugor në dalje të autoudhës A7 në drejtim të Prishtinës nga Mitrovica sipas kërkesës dhe rekomandimeve më 5.01.2021 në orën 4:00 të mëngjesit është bërë mbyllja e daljes së autoudhës A7 në drejtim të

Prishtinës si dhe njëri shirit i qarkullimit drejtimi Mitrovicë - Prishtinë. "Automjetet të cilat vijnë nga autoudha A7 për të vazhduar në drejtim të Prishtinës duhet të vazhdojnë në drejtim të fshatit Mazgit, më saktë në segmentin rrugor

Prishtinë - Mitrovicë dhe të shfrytëzohet rrethrotullimi në fshatin Mazgit (rrethrotullimi që gjendet në afërsi të tyrbes së Sulltan Muratit) dhe më pas të vazhdojnë në drejtim të Prishtinës", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.

## Prodhuesit vendorë kërkojnë mbështetje më të madhe nga shteti

PRISHTINË, 6 JANAR - Prodhuesit vendorë kërkojnë mbështetje më të madhe nga shteti për t'i mbuluar humbjet që sollti viti 2020. Pandemia Covid-19 krijoi vështirësi edhe për kompaninë "Pestova" nga Vushtrria që është prodhues e "Vipa Chips". Kjo kompani është ballafaquar me probleme të ndryshme në kohë pandemie, ndërsa muajt që kishte me së shumti humbje ishin muajt e parë pas shfaqjes së rasteve të para me Covid-19.

Menaxheri i prodhimit në këtë kompani, Agran Halimi, në një intervistë për "Kosova Press" ka thënë se në muajin mars dhe prill janë regjistruar humbje të mëdha, mirëpo ai thotë se kanë punuar pandërprerë që t'i zvogëlojnë humbjet. Ai treguar se pas



kalimit të dy muajve të parë të pandemisë në vend, edhe eksporti ka pasur rritje dukshëm me të madh, ku ka

ndihmuar kompaninë që ta marrë sadopak veten. "Muaji mars 2020 kur filloi pandemia dhe prill kanë qenë muajt të

cilët kanë rezultuar me humbje në kompaninë tonë", ka thënë Halimi. Ai ka theksuar se edhe masat

të cilat iu nënshtroheshin mjeteve transportuese në pikat kufitare në fillim të shfaqjes së pandemisë ndikuan në këtë kompani, pasi që nuk kanë mundur të arrijnë në vendin dhe kohën e duhur.

Halimi shton se mbështetja që është duke ofruar shteti për prodhuesit vendorë është e pamjaftueshme dhe se institucionet duhet të jenë më afër prodhuesve që të tejkalohet me lehtë kjo sfidë. "Institucionet qendrore dhe komunale duhet të jenë më afër prodhuesve dhe më afër ekonomisë, në mënyrë që të tejkalohet kjo sfidë", ka shtuar Halimi. Ai ka thënë se kjo kompani ka mbi 200 punëtorë dhe përkundër sfidave dhe humbjeve nuk kanë larguar asnjë punëtor nga puna.

## Programi ekonomik i AAK-së: Për Fondin e Mbijetesës Ekonomike do të ndahen një miliard euro

PRISHTINË, 6 JANAR - Fatmir Gashi, një prej themeluesve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), bashkë me ekspertë të tjerë, ka marrë përsipër hartimin e programit ekonomik 2021-2025, ku pjesë do të jetë projekti për Fondin e Mbijetesës Ekonomike me vlerë mbi 1 miliard euro për vitin 2021.

Gashi me anë të një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook"

ka thënë se Kosova ka nevojë për më pak politikë e më shumë punë konkrete. "Kosova ka nevojë për më pak politikë e më shumë punë konkrete. Paraja duhet kthyer te qytetari, taksapaguesi dhe ndërtuesi i shtetit. Në shtëpinë që e kemi themeluar bashkë në vitin 2000, AAK-në, po punojmë intensivisht për programin ekonomik 2021-2025, që pjesë përmbajtjesore

dhe prioritare do ta ketë projektin për Fondin e Mbijetesës Ekonomike me vlerë mbi 1 miliard euro për vitin 2021. Ky fond do të garantojë përkrahjen për bizneset, kthimin e punëtorëve që kanë humbur vendet e punës për shkak të gjendjes pandemike, mbështetjen për familjet në krizë ekonomike dhe përfitime të tjera", ka shkruar Gashi.





# Ministri Kuçi takon aktorët e sektorit pas pavarësimit energjetik

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 JANAR - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka mbajtur takimin e parë për vitin 2021 me aktorët e sektorit të energjisë: Korporatën Energjetike të Kosovës, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike të Kosovës, KEDS dhe KESCO.

Ky ishte takimi i parë mes këtyre aktorëve pas pavarësimit energjetik të Kosovës si rezultat i

marrëveshjes së kyçes mes KOSTT-it dhe Rrjetit Evropian të Transmisionit ENTSO-E.

Ministri Blerim Kuçi i falënderoi secilin prej tyre për punën e treguar gjatë periudhës transitorë 14-31 dhjetor 2020, ku është dëshmuar edhe ndaj Swissgrid-it që Kosova është e aftë të operojë në zonë të përbashkët rregulluese Kosovë - Shqipëri. Kjo marrëveshje për Kosovën ka shumë dobi të cilat vetëm se kanë filluar të ndihen, sipas kryeshefit të KOSTT-it, Mustafë Hasani, Kosova tashmë është palë e barabartë me rrjetet e tjera të

transmisionit në Evropë. "Gjithashtu, operojmë si zonë e përbashkët rregulluese Kosovë - Shqipëri dhe kemi filluar të inkasojmë të hyra nga energjia transite, që më parë janë marrë nga operatori serb", ka thënë Mustafa.

Në anën tjetër, kryeshefi i KEK-ut, Luigj Imeri, ka treguar se në ditën e fundit të fazës transitorë, më 31 dhjetor 2020, ka pasur një defekt në njërin prej blloqeve të KEK-ut, por është evituar shumë shpejt dhe në bashkëpunim me KOSTT-in e kanë stabilizuar energjinë elektrike që shkon te konsumatorët.

Në krahasim me natën e ndërrimit të moteve 2019-2020, ky ndërrim i moteve 2020-2021, sipas Bujar Jupajt nga KEDS-i, ka qenë më i stabilizuar falë motit të butë dhe gatishmërisë së ekipeve në terren.

Petrit Pepaj, drejtor i ZRRE-së, lavdëroi punën e të gjitha hallkave që mundësojnë furnizimin me energji elektrike, duke potencuar se Kosova është vonuar për instalimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

Në fund, ministri Blerim Kuçi, duke u ndërlidhur me fjalën e drejtorit të ZRRE-së, ka folur

për kapacitetet e reja gjeneruese. "Jemi në rregull me kapacitetet gjenerike nga energjia e ripërtëritshme, mirëpo stabilitet energjetik kemi vetëm nga gjenerimi me anë të thëngjillit, pasurisë sonë natyrore. Kjo është dëshmuar që është edhe më e sigurt, po në këtë kohë kur kemi pasur fazën transitorë të operimit si të pavarur, e që kemi pasur bllokadë nga linjat e transmisionit me Serbinë", ka thënë ministri Kuçi në fund të takimit, duke falënderuar secilin pjesëmarrës, mirëpo edhe gjithë stafin mbështetës të tyre.



## BQK-ja: Hoteleria, tregtia dhe ndërtimtaria, sektorët që shënuan rënie gjatë pandemisë

PRISHTINË, 6 JANAR - Përballja me pandeminë Covid-19 dhe ndërmarrja e masave për menaxhimin e krizës shëndetësore ndikuan që aktiviteti ekonomik i bizneseve të bie në Kosovë. Kështu thotë Banka Qendrore e Kosovës në raportin "Vlerësimi tremujor i zhvillimeve makroekonomike, tremujori i tretë 2020", duke shtuar se u godit sektori i hotelarisë, tregtisë e ndërtimtarisë. "Në baza sektoriale, në gjysmën e parë të vitit 2020, rënien më të lartë e shënuan sektori i hoteleve dhe restoranteve me 39 për qind, ndërtimtarisë me 35.5 për qind, transportit dhe magazinimi me



33.1 për qind, aktivitetet administrative dhe mbështetëse 22.8 për qind dhe

tregtia me 5 për qind", thuhet në raport.

Ndërsa rritje të aktivitetit ka

pasur sektori i informimit, shëndetësisë dhe furnizimit me energji elektrike. "Në anën tjetër, rritja më e lartë është shënuar te sektori i industrisë përpunuese me 15.7 për qind, informimit dhe komunikimit me 15.7 për qind, furnizimi me energji elektrike dhe gaz me 12.8 për qind, shëndetësia dhe puna sociale 11.1 për qind dhe industria nxjerrëse 5.8 për qind", theksohet në raportin e BQK-së.

Përkundër hapjes së ekonomisë, Banka Qendrore e Kosovës vlerëson se trendi i rënies së aktivitetit ekonomik ka vazhduar edhe në tremujorin e tretë 2020. BQK-ja

ka treguar se edhe Indeksi i Çmimeve të Konsumit shënoi rritje të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. "Pandemia Covid-19 ka ndikuar negativisht edhe në importin e mallrave, duke shkaktuar rënie prej 17.3-përqindësh në të hyrat tatimore indirekte të cilat arritën vlerën prej 335.5 milionë eurosh dhe përbëjnë 73.8 për qind të gjithë të hyrave buxhetore në tremujorin e tretë 2020. TVSh-ja dhe akciza, si dy kategoritë kryesore të të hyrave tatimore indirekte, shënuan rënie prej 14.9-përqindësh, përkatësisht 19.2 për qind", thuhet në këtë raport.

## Lladrovci shpall kandidaturën për mandatin e dytë për kryetar të Drenasit

DRENAS, 6 JANAR (ER) - Ramiz Lladrovci ka shpallur kandidaturën për mandatin e dytë për kryetar të Komunës së Drenasit. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se çështjen për kandidimin e tij për mandatin e dytë për kryetar komune e ka diskutuar më herët edhe me Kadri Veselin. "Kam pasur zotime për sigurinë e kandidaturës

time për mandatin e dytë në Degën e Drenasit dhe në kryesi të PDK-së. Ky zotim pritej të formalizohej gjatë nëntorit të kaluar nga kryetari Veseli. Për fat të keq, ndodhi goditja e rëndë për të gjithë neve, Haga", ka shkruar Lladrovci. Ai ka thënë se gjatë tërë jetës ka qenë dhe është njeri i besës dhe fjalës. "Ky deklaram imi ndoshta do të ketë pasoja për të gjithë, por

më së shumti për keqbërësit në zgjedhjet e ardhme qendrore dhe lokale. Pra, jam kandidat për kryetar të Drenasit edhe për mandatin e dytë. Vendimin për mandatin e dytë ua lë sërish në duar qytetarëve të Komunës së Drenasit. Pres që ata të vendosin, duan apo nuk duan, të më shohin në krye të komunës edhe katër vjet", ka thënë Lladrovci.



## Nismës në Malishevë i bashkohet një anëtar i PDK-së

Malishevë, 6 janar (ER) - Partisë së Fatmir Limajt të mërkurën i është bashkuar edhe një anëtar i PDK-së në Malishevë. Bëhet fjalë për profesorin e njohur në Qendrën e Kompetencës, Zenel Berisha. I sapoaderuari në Nismën Socialdemokrate, Zenel Berisha, ka thënë se ndihet i lumtur që është bërë pjesë e Nismës dhe se është tejet i motivuar që do të jetë krah njeriut të vetëm në skenën politike që sot po mbron vlerat tona kombëtare, Fatmir Limajn.



## Punimet për ndërtimin e parkingut nëntokësor po vazhdojnë sipas planifikimeve

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se punimet për ndërtimin e parkingut nëntokësor të Fakulteti i Filologjisë po vazhdojnë sipas

planifikimeve dhe me dinamikën e paraparë. Ai ka falënderuar të gjitha ekipet që po angazhohen që ky projekt i rëndësishëm kapital për Prishtinën të zbatohet dhe të jetësohet.



## Podujeva ia ndan 6 000 euro familjes së Blerim Maqastenës, të arrestuarit nga Serbia

PODUJEVË, 6 JANAR (ER) - Këshilltarët komunalë të Podujevës kanë marrë vendim që ta ndihmojnë me 6 000 euro familjen e këshilltarit të Partisë Socialdemokrate, Blerim Maqastena, i cili është arrestuar nga policia kufitare e Serbisë më 12 dhjetor të vitit të kaluar. Ky vendim është marrë njëzëri nga të gjithë këshilltarët komunalë të pranishëm në një

mbledhje të jashtëzakonshme e cila është mbajtur të mërkurën. Iniciuesja e kësaj seance, këshilltarja komunale Tringa Sfishta, ka thënë se arsyeja e thirrjes së mbledhjes së jashtëzakonshme është shprehja e mbështetjes dhe solidarizimi me kolegun e tyre asamblist, i cili padrejtësisht po mbahet në paraburgim nga

institucionet serbe. "Falënderoj të gjithë kolegët asamblistë të cilët mbështeten thirrjen e kësaj seance për ta shprehur pakënaqësinë tonë me aktin e ndodhur dhe për ta shprehur solidaritetin tonë në mbështetje të familjes Maqastena me mjete financiare, për shpenzimet e vizitave dhe angazhimeve të tjera", ka thënë Sfishta.



## Rinovohet oborri i 'Namazxhahut' që është pjesë e trashëgimisë kulturore



PRIZREN, 6 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, të mërkurën së bashku me ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, Cagri Sakar dhe kryetarin e Kryesisë së Këshillit Turk në Kosovë, Savas Yanar, kanë bërë përrurimin e renovimit të oborrit të "Namazxhahut", objekt ky i cili në Prizren është ndërtuar në shekullin XV dhe gjendet në listën

e trashëgimisë kulturore. Në kuadër të këtij projekti të financuar nga Republika e Turqisë është bërë shtrimi i shtigjeve për ecje me gurrë andezi, renovimi i çezmës së ujit, shtyllave të ndriçimit dhe mureve rrethuese, mbjellja e fidanëve si dhe ndërimi i tërësishëm i ulëseve për çlodhje dhe shportave për mbeturina. Pas kësaj, kryetari Haskuka së

bashku me ambasadorin Sakar zhvilluan një takim miqësor ku dhe biseduan për bashkëpunimin e mëtejshëm të Komunës së Prizrenit me institucionet e Republikës së Turqisë, të cilët, përveç investimeve të shumta në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, Komunën e Prizrenit po e mbështesin edhe në mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore.

# Minatori që frymëzoi regjimet komuniste për ta shpikur ‘Heroin e Punës Socialiste’



**Në dhjetor të vitit 1935, fotografia e kopertinës së revistës “Time” e paraqiti punëtorin e njohur sovjetik, Alexey Stakhanov – figurën e një lëvizjeje të re punëtore, kushtuar rritjes së prodhimit. Por, kohërat e mira për Stakhanovin nuk zgjatën përgjithmonë**

“Ai e donte punën e tij dhe gjithçka që ai arriti ishte përmes punës së tij të madhe, talentit dhe këmbënguljes së tij”, thotë Violeta Stakhanova, vajza e Aleksei Stakhanov.

Stakhanovi ishte minator në Donbass, një rajon qymyri në Ukrainën Sovjetike. Nën sistemin komunist, të gjitha minierat drejtoheshin nga shteti dhe kishin objektiva mujore për prodhimin. Nëse ata humbnin synimet, menaxherët lokalë dhe zyrtarët e Partisë Komuniste ishin në telashe. Miniera ku punoi Stakhanovi ishte me një nga performancat më të këqija në rajon.

“Ishte tepër konkurrues dhe vazhdoi të mendonte se si të rriste produktivitetin e minierës së tij dhe përfundimisht doli me një zgjidhje të shkëlqyeshme”, thotë Violeta.

Në vitet 1930, minatorët zgjidhën mënyra të ndryshme për të punuar qymyri në cili më pas u tërhoq nga pusi e nga gropat dhe u ngarkua në karroca. I shtrirë në krah ose në shpinë, një minator mund të thyente qymyri. Ai gjithashtu kishte një sërë rekuizitash – trungje të prera në gjatësi të ndryshme -dhe kohë pas kohe mbështeste kokën në çatinë e tunelit ku punonte.

Stakhanovi doli me idenë që një minator të nxirrte vazhdimisht qymyr, ndërsa një tjetër ta ngarkonte qymyri në karrocë,

një minator i tretë mbante çatinë me gropa dhe një i katërt të bënte transportin brenda dhe jashtë. Dhe, në vend të zgjedhjes tradicionale, Stakhanovi ishte i etur të përdorte këtë praktikë pune në miniera. Puna ishin jashtëzakonisht e rëndë, pasi ngarkesa peshonte më shumë se 15 kilogramë.

“E bëri një kurs dhe mësoi ta përdorë këtë metodë”, thotë Violeta. “Nuk kishte arsim, përveç shkollës fillore, por ai ishte i vendosur.”

Menaxheri i minierës kishte dyshime serioze në lidhje me nismën e Stakhanovit. Sidoqoftë, e bindi udhëheqësin e ekipit të tij dhe shefin lokal të partisë, që ta përdornin këtë nismë.

Më 30 gusht të vitit 1935, në orën 22:00, Alexei Stakhanov dhe tre kolegë hynë në minierë, të shoqëruar nga shefi i partisë dhe nga një gazetar lokal. Gjashtë orë më vonë, u shfaqën triumfues, pasi kishin prodhuar 102 tonë qymyr – 14 herë më shumë se objektivi.

Stakhanovi merr vëmendje dhe u lavdërua menjëherë për këtë arritje: një delegacion i grave lokale i dhuruan atij lule, gazeta lokale botoi historinë e tij dhe ministri sovjetik i Industrisë, Sergo Ordzhonikidze, ia tregoi historinë udhëheqësit sovjetik, Josif Stalin. Shumë shpejt, një artikull që vlerësonte “metodën Stakhanov” u shfaq në gazetën qendrore të Partisë, ‘Pravda’.

Sapo u miratua nga Stalini, metoda filloi të përhapet në të gjithë Bashkimin Sovjetik.

“Babai im u shpërblye me një banesë të vogël të mobiluar, madje edhe me një kalë me karrocë për të udhëtuar, sepse në ato kohë ata nuk kishin makina. Babai ishte krenar për kalin”, thotë Violeta.

Por, ajo kujton një histori që i tregoi babai i saj, i cili i thoshte se “jo të gjithë kolegët e mirëpritën arritjet e tij!”

“Një herë, një grup i punëtorëve lokalë kërcënuan babanë tim me një thikë duke e akuzuar se: ‘Pse po përpiqeni të na impononi objektiva tuaja të reja. Ne patëm një jetë të mirë edhe pa iniciativat tuaja!’”

Por, Stakhanovi i kundërshtoi ata. Me mbështetjen e Partisë Komuniste, filloi të udhëtonte nëpër Bashkimin Sovjetik duke e promovuar iniciativën e tij.

Në pamundësi për të përballuar statusin e tij të famës, e dashura e tij, një grua rome e quajtur Yevdokia, e la për një burrë tjetër. Ajo i la dy fëmijët e tyre me Stakhanovit, duke menduar se ata mund të kishin një të ardhme të ndritur me babanë e tyre të famshëm.

Por, duke vizituar vendin, Stakhanovi nuk i mungoi vëmendja e grave. Pasi ai ishte duke vizituar një shkollë në qytetin Kharkov, ku nxënësit dhanë një koncert për ta mirëpritur, kur një vajzë e quajtur Galina Bondarenko doli në skenë për të kënduar një këngë, Stakhanovi u dashurua me këtë vajzë..

Galina ishte gjysma e moshës së Stakhanovit; vinte nga një familje e arsimuar mirë, por e varfër. Pas martesës, ajo u kthye në shkollë

dhe vazhdoi studimet.

“Babai im e adhurroi atë”, thotë Violeta për nënën e saj. “Ajo nuk e donte saktësisht atë, por e respektonte, si një plak. Unë nuk mendoj se ajo ishte dashuruar me pasion me të, ashtu siç janë disa gra me burrat e tyre”

Gjatë muajve të ardhshëm, duke udhëtuar nëpër vend, Stakhanovi frymëzoi mijëra mbështetës nga të gjitha degët e industrisë dhe bujqësisë sovjetike të cilët ishin të lumtur të zbatonin idetë e tij për të rritur produktivitetin. Në nëntor të atij viti, u mbledh në Moskë Konferenca e Parë e ‘Lëvizjes Stakhanov’. Një reporter nga revista ‘Time’ e ndoqi ngjarjen. Lindi një fjalë e re – ‘Stakhanovist’ që do të thotë një person që punon jashtëzakonisht shumë.

Mijëra punëtorë të lumtur fshinin lotët e gëzimit, ndërsa dëgjonin liderin sovjetik, Josif Stalin, duke lexuar fjalimin e tij në konferencë. “Jeta është bërë më e lehtë, shokë; jeta është bërë më e lumtur. Dhe, kur dikush është i lumtur, puna shkon mirë. Nëse jeta jonë do të ishte e vështirë, e trishtuar dhe pa gëzim, nuk do të kishim pasur lëvizjen, Stakhanoviste”, shprehej në mes të tjerash lideri suprem i Kremlinit

Fjalimi i Stalinit asokohe u prit me duartrokite të zjarrta dhe dekada më vonë rusët kujtonin me sarkazëm fjalët e Stalinit ku thoshte se: “Jeta u bë më e lumtur”, por për shumicën e qytetarëve sovjetikë, vitet 1930 në të vërtetë ishte një kohë urie, si dhe shtypjeje brutale.

Por, për Alexei Stakhanovit, në atë kohë gjërat vërtet po shikonin mirë. Partia Komuniste i dha atij një apartament elitare në Moskë dhe një punë në Ministrinë e

Industrisë së Rëndë dhe Minerave. Gruaja e tij e re e bukur, Galina, e ndihmoi për të “lundruar” në politikën makiaveliane të kryeqytetit sovjetik.

“Një herë, në një pritje, Stalini e prezantoi mamanë time, në sy të të gjithëve – ajo ishte gjithnjë elegante – dhe ai tha: ‘Jam i kënaqur t’ju prezantoj me gruan e ministrit tonë të ardhshëm të qeverisë’. Babait tim gati i ra të fikët. Ai ishte tmerruar. Nëna më tha më vonë se ajo duhej t’i shtrëngonte dorën, për ta qetësuar. Përfundimisht, babai tha: ‘Faleminderit për nderin, por unë nuk kam arsim të mjaftueshëm’”.

Jeta në Moskë kishte rreziqe të tjera. Një ditë Galina ishte jashtë për të bërë pazar, kur vuri re një makinë që ecte ngadalë pas saj. Automjeti ndaloi së bashku dhe një oficer dhe me mirësjellje i kërkoi asaj të hynte brenda. Ajo hyri në makinë duke e pyetur se ku do të shkonin, por oficeri refuzoi të zbulonte destinacionin e tyre. Ajo u dërgua në rezidencën e Lavrenty Beriaa, një nga bashkëpunëtorët më të frikshëm të Stalinit. Në vitet 1930-’40, Beria dërgonte ndihmësit e tij për të rrëmbyer gra të bukura në rrugët e Moskës. Padyshim që Galina i kishte rënë në sy për paraqitjen e saj.

“Ajo hyri brenda dhe një oficer tjetër doli ta takonte”, thotë Violeta. “Ajo tha: ‘Unë jam gruaja e Stakhanovit dhe jam shtatzënë. Nuk e di pse jam këtu?! Oficeri ishte shumë i zgjuar, ai thirri dikë menjëherë dhe ata e lëshuan dhe e çuan në shtëpi brenda disa minutash. Më pas babai u tërbua dhe i tha: ‘Si mund të hipje në makinë me ta? Ti e di se çfarë u bëjnë ata grave...’”?


Në 20 vitet e tij në Moskë, Stakhanovi nuk u mësua kurrë me jetën e tij të re të ndërlikuar dhe i mungonin ish-kolegët e tij.

Në vitin 1957, katër vjet pas vdekjes së Stalinit, lideri i ri Sovjetik, Nikita Khrushchev, nuk pa asnjë nevojë për të mbajtur Stakhanovit në Moskë dhe e urdhëroi atë të kthehej në Donbass. Stakhanov ndjeu se ishte në një internim virtual – veçanërisht pasi familja e tij mbeti në Moskë – dhe kaloi 20 vitet e fundit të jetës së tij duke abuzuar me pije.

Violeta kujton se babai i saj ishte veçanërisht i mërzitur që Partisë Komuniste iu deshën plot 35 vjet për t’i dhënë çmimin më të lartë sovjetik, “Heroin e Punës Socialiste”. Ai mori medaljen vetëm në vitin 1970.

Aleksey Stakhanov vdiq pas një ataku kardiak në Donbass, në Ukrainën lindore, në vitin 1977.

/Memorie.al/



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Ylli triumfon kundër Pejës, Prishtina shijon fitoren në Gjakovë



**SUHAREKË, 6 JANAR** - Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore ndaj Pejës me rezultat 89:73 (20:14, 20:19, 16:23, 33:17) në kuadër të javës së 13-të në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll. Vendasit e nisën ndeshjen më mirë, duke fituar çerekun e parë 20:14. Lojë më e baraspeshuar u zhvillua në periudhën e dytë, që përfundoi 20:19, derisa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 40:33. Në periodën e tretë më të mirët ishin pejanët. Ata fituan këtë pjesë 16:23, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 56:56. Kjo e bëri ndeshjen shumë interesante. Megjithatë, në periudhën e fundit

therandasit ishin shumë më të mirë 33:17, për të triumfuar në fund 89:73. Te Golden Eagle Ylli u dalluan Cody John me 27 pikë e gjashtë asistime, Valon Bunjaku me 22 pikë, katër kërcime e pesë asistime dhe Samir Zekiçi me 16 pikë, gjashtë kërcime e katër asistime, derisa te Peja u dalluan Robert Cartëright me 26 pikë e pesë asistime dhe Brandon Walters me 16 pikë e 13 kërcime. Tani të dyja skuadrat kanë nga tetë fitore dhe pesë humbje. Ndërsa në ndeshjen tjetër që u zhvillua të mërkurën KB Sigal Prishtina ka shënuar fitore ndaj Vëllaznimit në udhëtim me shifrat 62:69 (18:17, 17:12, 17:23, 10:17), në kuadër të javës së 13-të në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshja nisi e baraspeshuar, ku çereku i parë përfundoi 18:17. Vendasit ishin më të mirë në periudhën e dytë, që përfundon 17:12, derisa skuadrat shkuan në pushim me shifrat 35:29. Por, prishtinasit ishin më të mirë në pjesën e dytë, duke e fituar edhe këtë

duel. Periodën e tretë e fitojnë 17:23 dhe atë të fundit 10:17, duke triumfuar në fund 62:69. Te Vëllaznimi u dalluan Cendrik Council me 23 pikë e 11 kërcime, Christopher Hortman me 14 pikë e 15 kërcime dhe Devonte Jackson me 15 pikë e 10 kërcime, kurse te Sigal Prishtina më i miri ishte Daniel Lekndreaj me 22 pikë e gjashtë kërcime. Tani të dy skuadrat kanë nga katër fitore dhe nëntë humbje.

## Sot zhvillohen dy ndeshje

Të enjten zhvillohet derbi i qytetit ndërmjet Bashkimit dhe Ponte Prizrenit, dy skuadra që janë në formë shumë të mirë. Bashkimi ka gjashtë fitore dhe gjashtë humbje, kurse Ponte Prizreni nëntë fitore dhe tri humbje. Trepça që ka bërë disa ndryshime në skuadër do të ndeshet me Rahovecin, që ka synime të mëdha në këtë edicion. Mitrovicasit kanë dy fitore dhe dhjetë humbje, kurse Vreshtarët nëntë fitore dhe tri humbje.

## SHKURT

### Kastrati përforcon Yllin

Lojtari i Përfaqësueses së Kosovës në basketboll, Erjon Kastrati, është bashkuar me Golden Eagle Yllin. Ka qenë klubi suharekas që ka njoftuar për nënshkrimin me basketbollistin e njohur që ka bërë karrierë në Slloveni. "Erjon Kastrati është bashkuar me ne. Ju njoftojmë që kemi arritur marrëveshje me lojtarin e Përfaqësueses së Kosovës në Basketboll, Erjon Kastratin. Kastrati ka një karrierë shumë të pasur në basketbollin evropian, kryesisht në Slloveni, ku ka dërsitur fanellën e ekipeve si Union Olimpia, Krka Novo Mesto, Egis Kormend dhe se fundmi Sixt Primorska. Mire se vjen, Erjon!", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Suhareka.

### Rusi largohet nga Arbëria

Futbollisti Gëzim Rusi nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së Arbërisë së Dobrajës. Lajmin e ka bërë me dije vetë futbollisti i cili paralajmëron se shumë shpejt do të bëhet me skuadër të re. "Me këtë postim dua t'ju njoftoj që nuk jam më pjesë e klubit KF Arbëria. Falënderoj kryesinë e klubit për korrektësinë dhe i uroj suksese", ka shkruar Rusi.

### Liverpooli nuk e lejon largimin e Shaqirit

Xherdan Shaqiri nuk do të largohet nga Liverpooli të paktën deri në verën e këtij viti për shkak të gjendjes së shkaktuar nga pandemia e koronavirusit dhe kriza e lëndimeve në skuadrën që drejtohet nga Jurgen Klopp. 29-vjeçari nga Gjilani ka kaluar nëpër një periudhë të vështirë në dy sezonet e fundit në "Anfield" për shkak të lëndimeve të shpeshta, të cilat ia kanë pamundësuar të luajë mjaftueshëm. Ai i bëri vetëm 11 paraqitje në të gjitha garat për Liverpoolin sezonin e kaluar, ndërsa këtë sezon po e përjeton fatin e njëjtë, sepse i ka bërë vetëm shtatë paraqitje deri tani. Megjithatë, Shaqiri e ka tejkaluar lëndimin e pulpës tani dhe pritet të jetë në dispozicion të trajnerit gjerman për orarin e ngjeshur të ndeshjeve në muajt në vazhdim.

## SUPERLIGA - Java 13

Golden Eagle Ylli - Peja **89:73**  
Vëllaznimi - Sigal Prishtina **62:69**

### Të enjten takohen:

15:00 Trepça - Rahoveci  
15:00 Bashkimi - Ponte Prizreni

## Arb Manaj shpallet Sportisti i Vitit 2020 në Klinë

**Klinë, 6 janar** - Futbollisti Arb Manaj është shpallur Sportisti i Vitit 2020 në Komunën e Klinës. Manaj, i cili karrierën në futboll e ka filluar në KF Dukagjini, tash luan me sukses për klubin turk Ankara Keciorengucu. "Arbi ka një të kaluar sa të dhimbshme aq dhe krenare dhe frymëzuese.

Djalë i një familje atdhetare e të cilit kriminelët serbë ia vranë prindin kur Arbi ishte vetëm tetë muaj. Por, me mbështetjen e familjes, me angazhim të jashtëzakonshëm, disiplinë, talent dhe dashuri për futbollin, Arbi ka arritur ta përmbushë ëndrrën e tij, duke

u bërë futbollist profesional shumë i suksesshëm dhe duke qenë shembull për t'u ndjekur nga të rinjtë e tjerë për realizimin e qëllimeve të tyre e duke na bërë krenarë të gjithë neve", ka shkruar Zenun Elezaj, kryetar i Komunës së Klinës. Me mirënjohje për kontributin

e dhënë për zhvillimin e sportit në Klinë dhe Kosovë është nderuar veterani i futbollit, Sali Marmullaku, i cili karrierën si portier e ka filluar në vitin 1970 dhe ishte ndër futbollistët e parë shqiptarë të ish-KF Malishgani dhe ka dhënë kontribut të madh për pavarësimin e



sportit të Kosovës ndaj Serbisë dhe për emërimin e klubeve të sportit të Klinës me emrin "Dukagjini".

## Hysaj, më afër rinovimit se largimit nga Napoli

**NAPOLI, 6 JANAR** - Kontrata e Elseid Hysajt me Napolin skadon në qershor të këtij viti, por që prej ditës së martë mbrojtësi shkodran i Kombëtares Shqiptare ka fituar të drejtën për të nënshkruar me cilin klub të dojë për sezonin e ardhshëm. Menaxheri italian Mario

Giuffredi, i cili kujdeset për interesat e Hysajt, deklaroi për mediat italiane se momentalisht gjasat më të mëdha janë që mbrojtësi të largohet nga Napoli, por nuk e mbylli derën e një rinovimi të mundshëm. "E sigurt është që do ta mbyll këtë sezon me Napolin, më pas të shohim se

çfarë do të ndodhë. Ka 51 % mundësi që të rinovoj me Napolin, pasi ai dëshiron të qëndrojë, por drejtuesit e klubit i kanë në tavolinë kërkesat tona. Nëse te Napoli zgjohen nesër dhe vendosin të rinovojnë, atëherë do ta bëjmë. Megjithatë, nuk jemi të shqetësuar, pasi kemi oferta

edhe nga jashtë", ka deklaruar Giuffredi. Napoli pagoi 5 milionë euro në verën e 2015-s për ta blerë kartonin e shkodranit nga klubi i Empolit, ndërsa në pesë sezone e gjysmë, Hysaj numëron 199 ndeshje me fanellën e kaltër dhe vetëm një gol të shënuar.



## Ramadani: Përforcimet më të mëdha janë kthimi nga lëndimi i Gavazajt dhe Shillovës

**PRISHTINË, 6 JANAR** - FC Prishtina ka filluar të mërkurën përgatitjet për sezonin pranveror. Prezent në fushën ndihmëse të klubit në Bernicë ishin të gjithë futbollistët përveç sulmuesit Oto John i cili skuadrës do t'i bashkëngjitet pas disa ditësh. Trajneri i klubit kryeqytetas, Zekirija Ramadani ka thënë se rikthimi nga lëndimi i Enis Gavazajt dhe Alban Shillovës. "Fillojmë me përgatitjet dhe pozitiv është fakti që të gjithë futbollistët janë prezent, përveç John që ka probleme me dokumentacion dhe do të rikthehet pas disa ditëve nga Nigeria. Lëndimet që kishin Gavazaj dhe Shillova janë tejkaluar, janë mirë dhe janë përforcim shumë i mirë, sepse deri tani nuk kanë qenë në qindpërqindtëshin e tyre. Tani janë të gatshëm dhe me kualitetin që posedojnë do të ndihmojnë skuadrën drejt objektivave që kemi para nesh. Kemi futbollistë me karakter të fortë", ka thënë trajneri Ramadani. "Falë Zotit koha po na merr shumë mirë duke i pasur kushtet optimale për punën dhe jam i bindur me punën cilën do ta bëjmë, duke e njohur karakterin që kanë futbollistët, do të arrijmë formën optimale deri në



fillimin e kampionatit. Kemi futbollistë shumë profesionist dhe nuk do ta kemi fare problem këtë fazë të vështirë të përgatitjeve fizike. Është fazë shumë e vështirë për çdo futbollistë dhe që e kemi kaluar edhe ne, mirëpo karakteri i tyre më lejon të flas me bindje të plotë që nuk do të kemi asnjë problem. E shpresoj të mos na përcjellin as lëndimet dhe të japim maksimumin", ka shtuar Ramadani. Lidhur me transferet që mund të bëhen ditëve të ardhshme, trajneri Ramadani ka deklaruar: "Futbollistët të cilët i kemi liruar tani më e dini të gjithë, nuk kemi llogaritur në ta dhe i kemi liruar. Për prurje të reja, përveç Ardit Nikës, nuk dua as të flas as të përmend emra, por jemi në bisedime me disa dhe në një kohë shumë të shkurtër gjithçka do të pasqyrohet".

### Nika pas dy vitesh rikthehet te Prishtina

Portieri Ardit Nika rikthehet në skuadrën e Prishtinës pas dy vitesh qëndrimi si portier i parë i Flamurtarit. "Besoj shumë se jam duke bërë zgjidhjen e duhur me rikthimin tim tek Prishtina. Besoj se mund t'i arrij ambicjet të cilat i kam, që do të thotë se pretendoj që mos të lëviz nga skuadra. Kam besim të plotë se me angazhim maksimal do t'ia arrij të jem portier i parë i skuadrës. Jam i ri, koha është në favorin tim, jam në klubin e duhur, në klubin më të madh në vend dhe me mbetët të punoj shumë dhe të dëshmoj cilësitë që kam", ka thënë Nika për faqen zyrtare të Prishtinës.

## Lakersat triumfojnë ndaj Memphiesit

**LOS ANGELES, 6 JANAR** - Kampioni në fuqi i NBA-së, Los Angeles Lakers, po konfirmon sërish se është në superformë, pasi ka siguruar edhe fitoren e katërt radhazi, që është e gjashta sezonale, në tetë ndeshje të luajtura. Transferi e "FedExForum" ndaj Memphies Grizzliesit rezultoi të ishte më e komplikuar për kalifornianët, që në fund ia dolën të fitojnë me vetëm dy pikë dallim, me rezultatin final 92-94. Vendasit e nisën mirë ndeshjen dhe fituan fraksionin e parë, por më pas loja foli për Lakersat, që fituan të tria pjesët e tjera, ndonëse me rezultat shumë të ngushtë, falë edhe formës së mirë të LeBron Jamesit e Anthony



Daviesit, që shënuan gjithsecili nga 26 pikë. Një sfidë mjaft spektakolare u zhvillua edhe në "Staples Center" të Los Angelesit, mes Clippersave vendas dhe San Antonio Spursit, me këta të fundit që ia dolën të triumfojnë me rezultatin e ngushtë 113-116. Kawhi Leonard ishte në një

formë spektakolare, pasi shënoi 30 pikë, rikuperoi 3 topa dhe dha 10 asistime, megjithatë të gjitha këto nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen e tretë sezonale për Clippersin, ndërsa te Spursi spikatën Murray dhe Mills. Denver Nuggetsit regjistroi fitoren e tretë sezonale, pasi mposhtën me rezultatin 123-116 Minnesota Timberwolves në "Ball Arena". Serbi Jokiç ishte protagonist absolut për vendësit, pasi shënoi 35 pikë, rikuperoi 15 topa dhe dha 6 asistime. Në ndeshjet e tjera, Brooklyn Netsi triumfoi me shifrat 130-96 ndaj Utah Jazzit, ndërsa Chicago Bulls fitoi me shifrat 108-111 në transfertën ndaj Portland Trail Blazersit.

### SHKURT

#### PSG-ja projekton formacion të frikshëm për sezonin e ardhshëm

Teksa në futbollin botëror po ndihet jo pak kriza nga pandemia e Covid-19, që ka sjellë humbje të mëdha, PSG po bën plane të mëdha për të ardhmen. Ëndrra është sigurisht Lionel Messi, i cili mund të merret falas në verë nëse nuk do ta rinovojë kontratën me Barcelonën. Një tjetër objektivi është edhe Sergio Ramos, i cili gjithashtu mund të merret falas, pasi ndodhet në të njëjtën situatë me Realin. "The Sun" ka përfituar nga thashethemet për ta ndërtuar formacionin e mundshëm për sezonin e ardhshëm. Në portë është Lloris. Në mbrojtje Dagba, Sergio Ramos, Marquinhos dhe Bakker, në mesfushë Verrati, Gueye dhe Dele Alli, ndërkohë që sulmi është magji Messi-Mbappe-Neymar.

#### Bottas: Ky është sezoni i duhur për titullin

"Po plakem, por e ndiej që jam më i shpejtë në pistë. Gjithashtu, ndiej se këtë vit do të kem më shumë shanse të dueloj për titullin në Formula 1". Ka qenë kjo deklarata e dhënë nga piloti finlandez Valtteri Bottas, që shpreson ta ndalë hegjemoninë e shokut të tij të skuadrës Lewis Hamilton. Të dy pilotojnë makinën kampione Mercedes. "Mendoj se gjatë vitit 2020 kam pasur një ritëm konstant në garë, që natyrisht mund të përmirësohet. Janë disa detaje që duhen përmirësuar, ashtu sikurse bëri Lewisi. Mendoj se ende nuk kam arritur në majën e karrierës time", ka thënë Bottas. Finlandezi beson te titulli i parë kampion në Formula 1: "Çdo objektivi është i arritshëm. Nuk ndiej presion, pasi punoj shumë për të arritur maksimumin në pistë".

#### City konfirmon tri raste të reja me Covid

Rastet me Covid-19 te skuadra e Manchester Cityt duket se nuk kanë të ndalur. "Qytetarët" sot (e mërkurë) kanë njoftuar për tri raste të tjera. Klubi anglez ka konfirmuar se Scott Carson, Cole Palmer dhe një pjesëtar i stafit kanë rezultuar pozitiv në analizat e koronavirusit. Të gjithë janë në izolim duke ndjekur protokollin e Premierë Ligës. "Manchester City mund të konfirmojë se Scott Carson, Cole Palmer dhe një pjesëtar i stafit kanë rezultuar pozitiv me Covid-19", thuhet në njoftimin e Cityt.

#### De Rossi: Dua të bëhem trajner i Boca Juniorsit

Daniele De Rossi ka vendosur të bëhet trajner. Ish-mesfushori i njohur italian ka nisur të studiojë dhe së shpejti do ta shohim në bankinën e ndonjë skuadre. Vitin e fundit të karrierës e kaloi te Boca Juniorsit, ekipi për të cilin bën tifo pas Romës së tij të dashur. "Më mungojnë Argjentina dhe Boca Juniorsi. Unë dhe familja ime e shijam çdo moment të kohës që kaluam atje. Sidomos jashtë fushave, pasi në fushë nuk ia dola të lësh shenjën time dhe të bëja atë që doja. Më kushtoi shtrenjtë dëmtimi i parë. Përjetova një përvojë të paharrueshme në Argjentinë, por vjen një moment kur duhet të marrësh një drejtim. Familja është gjëja më e shtrenjtë për mua, prandaj vendosa të kthehem në shtëpi. E ardhmja si trajner? Po studioj dhe aventurën e parë si trajner do ta përjetoj në Evropë. Por nëse do të më duhet ta kaloj oqeanin, do ta bëja vetëm për Boca Juniorsin. Do të më pëlqente ta drejtoja një ditë atë ekip", ka deklaruar De Rossi.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

ÇMIMI: 5.99 €



**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

[nga Moisiu deri te Kieślowski]

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €



Daut Dauti

**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

Daut Dauti

novelë



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Ex Fis" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Shupkoc, Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.02.2021 në ora 11:00 në hapësirat e restorant Pizzeria "HIB-PETROL" në Shupkoc, Mitrovicë do të organizohet debat publik nga kompania "Ex Fis" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Shupkoc, Mitrovicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/73446042713?pwd=WETvcTlOMSS1NUIMZGsyQVllQm5Zdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit me Nr.48, gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 07.01.2021 të shpallë:

### KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës:

**Automekanik Njësia në Mitrovicë - me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi**

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**

- Punon në servisimin dhe riparimin e të gjitha llojeve të automjeteve;
- Teston dhe kontrollon rregullësinë për mbajtje në gjendje të rregullt pune të automjeteve;
- Teston dhe provon rregullësinë e punës së motorit, ndrruesit, boshitit rrotullues, alternatorit, frejt, përquesit, lyrjen e motorit, pastrimin e filterave.
- Kryen edhe punë tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit të drejtëpërdrejtë

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme drejtimi automekanik;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 3-6 muaj);
- Të ketë më së paku 3 vite përvojë të punës si automekanik;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 07.01.2021 deri më datën 21.01.2021. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Flurije Shala, shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës fillore "Kajtas Ramadani" Kijevë.

► Përkthime gjyqësore internacionale L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811481100.

► Veton Pacolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme si dhe diplomën SH.M.E. "Gjin Gazulli" Prishtinë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Ex Fis" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.02.2021 në ora 11:30 në hapësirat e restorant Pizzeria "HIB-PETROL" në Shupkoc, Mitrovicë do të organizohet debat publik nga kompania "Ex Fis" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Mitrovicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/73446042713?pwd=WETvcTlOMSS1NUIMZGsyQVllQm5Zdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

